

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I LARTE I DREJTESISE

V E N D I M

NR. 127 Date 27/05/2002.

Per shkarkim nga detyra te gjyqtarit Agim Hysi

Keshilli i Larte i Drejtesise ne mbledhjen e dates 27/05/02, mbasi mori ne shqyrtim kerkesen e Ministrit te Drejtesise per procedimin disiplinor dhe shkarkimin nga detyra te gjyqtarit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, Agim Hysi dhe pasi degjoi pretendimet e tij

Konstaoi se:

Nga ana e gjyqtarit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, Agim Hysi, jane kryer veprime te pahijshme qe cenojne rende etiken gjyqesore si dhe veprime ne kundershtrim me permbushjen e rregullt te detyres ne gjykimin e disa çeshtjeve penale per vitin 2000-2001 ne te cilat ka mare pjese si kryesues apo antar i trupit gjykues, e konkretisht:

1- Ne mbledhjen e dates 06/09/01, ne zyren e Kryetarit te Gjykates se Rrethit Vlore, ne prani te gjyqtareve te kesaj gjykate gjyqtari Agim Hysi ka cenuar rende etiken gjyqesore duke ofenduar me fjale fyese e banale kryetarin e gjykates z. Sazan Aliko. Ne kete takim, ai e ka fyer kryetarin e gjykates duke i thene "ti je maskara, fallsifikator, tere kohen me poshtersira je mare, e ke kthyer gjykaten ne prone private etj", qe rezultojne te provuara nga shpjegimet e kryetarit te gjykates dhe gjyqtareve te pranishem ne mbledhje.

2- Ka shkelur kerkesat e nenit 128/1 pika A te K.Pr.Penale mbi kushtet per formimin e trupit gjykues.
Gjyqtari Agim Hysi me cilesine e kryesuesit te trupit gjykues ka shqyrtuar kerkesen per rishikimin e Vendimit penal Nr. 64 dt. 08/07/99, qe i perket te

pandehurit Genci Barjami i denuar me 8 vjet burg ne mungese per vepren penale te vjedhjes se bankave ne bashkepunim parashikuar nga Neni 136-25 te K.Penal. Me vendimin Nr. 28 dt. 06/02/01, trupi gjykues ka vendosur te deklaroje te pafajshem te pandehurin duke urdheruar lirimin e tij nga burgu. Gjate gjykimit te kesaj ceshtjeje, ne daten 22/12/00, eshte celur seanca gjyqesore me trup gjykues te perbere vetem nga dy gjyqtare, Agim Hysi e Mirela Mishgjoni, dhe nderkohe jane kryer veprime proçeduriale si pranim i kerkesave paraprake te paleve, ne kundershtim me Nenin 128/1 pika A te K.Pr.Penale. Per kete shkak, Gjykata e Apelit me Vendimin numer 177 dt. 13/07/01, ka vendosur prishjen e Vendimit numer 28 dt. 06/02/01, dhe kthimin e ceshtjes per rigjykim me tjeter trup gjykues.

3- Ka shkelur kerkesat e Nenit 387 te K.Pr.Penale mbi pushimin e ceshtjes penale.

Ne ceshtjen penale me te pandehur Viron Qejvani i akuzuar per vepren penale te vjedhjes me arme kryer ne bashkepunim parashikuar nga Neni 140-25 i K.Penal, trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtari Agim Hysi me Vendimin Nr. 163 dat. 20/07/01, ka vendosur pushimin e gjykimit te ceshtjes per mungese te kushteve te proçedimit sipas Nenit 387 te K.Pr.Penale, si dhe ka urdheruar lirimin e menjehershem nga burgu te te pandehurit.

Vendimi mbi pushimin e gjykimit te ceshtjes eshte dhene ne kundershtim te hapur me kerkesat e Nenit 387 te K.Pr.Penale pasi nuk ka ekzistuar asnje kusht proçedimi apo shkak qe te shuante vepren penale. Duke vendosur pushimin e ceshtjes, trupi gjykues nuk e ka lejuar organin e akuzes qe te sillte prova para gjykates per te provuar fajesine sipas nje proçesi te rregullt gjyqesor. Gjykata nuk ka kryer shqyrtimin gjyqesor te ceshtjes dhe nuk ka pyetur asnje prej deshmitareve sipas listes qe i eshte derguar gjykates bashkengjitur me fashikullin e gjykimit.

Pretendimi i gjyqtarit te proçeduar, se lirimi i te pandehurit Viron Qejvani eshte pasoje e mbajtjes ne burg pa te drejte per shkak te plotesimit te afatit 1 vjeçar te paraburgimit ne fazen e hetimeve paraprake, nuk qendron.

- Se pari, nga arsyetimi i vendimit te pushimit del qarte se lirimi i te pandehurit eshte pasoje e nje vendimi perfundimtar te dhene nga gjykata, (ne rastin konkret vendimi i kunderligjshem i pushimit te ceshtjes Nr. 163 dt. 20/07/01), qe ka pas-sjell shuarjen e mases se sigurimit arrest ne burg sipas Nenit 261 paragrafi i I-re pika A i K.Pr.Penale.

- Se dyti, organi i hetimit nuk e kishte konsumuar afatin 1 vjeçar te paraburgimit te parashikuar ne Nenin 263 paragrafi i I-re pika B te K.Pr.Penale, qe mund te sillte si pasoje humbjen e fuqise se afateve te paraburgimit. Duke mare parasysh daten e arrestimit 31/05/00 deri ne daten e dergimit te dosjes ne gjykate 16/01/01, si dhe afatin e hetimit prej dates 18/04/01 qe dosja i është kthyer prokurorise nga gjykata per hetime te metejshme deri ditën e ridergimit te dosjes ne gjykate date 30/05/01, rezulton se organi i hetimit ka konsumuar 8 muaj e 28 dite.

Ne keto rrethana, arsyetimi i perdorur ne vendimin e gjykates se i arrestuari është mbajtur ne burg ne menyre te padrejte tej afateve te paraburgimit, jo vetem është i pavertete, por nuk mund te sherbeje si nje nder shkaqet, krahas shkaqeve te tjera, qe kushtezon pushimin e gjykimit te çeshtjes.

4- Ka shkelur kerkesat e Nenit 375 te K.Pr.Penale duke bere ndryshimin e cilesimit juridik te veprave penale me tendence zbutjeje.

Me gjykimin e 9 çeshtjeve penale ndaj personave te cilet jane kapur me bime narkotike "Canabis Sativa", trupi gjykues ku gjyqtari Agim Hysi ka qene kryesues apo antar, pasi ka pranuar gjykimin e shkurtuar, ka bere ndryshimin e cilesimit juridik te vepres nga vepra penale e prodhimit dhe shitjes se narkotikeve Neni 283/1 i K.Penal ne vepren penale te mbajtjes se paisjeve per prodhimin e narkotikeve parashikuar nga Neni 285 i K.Penal, i cili parashikon denime me te buta. Per pasoje jane favorizuar te pandehurit ne masat e denimit.

Ne kundërshtim me ligjin Nr. 7975 dt. 26/07/95 "Per barnat narkotike dhe lendet psiko-trope", Konventes Unike Evropiane per Barnat Narkotike e vitit 1961 dhe akt-ekspertimet kimike te cilat percaktojne se bima "Canabis Sativa" është bime narkotike qe hyn ne kategorine e droges, gjykata ne menyre subjektive e ka konsideruar lenden narkotike qe u është kapur te pandehurve si substance qe perdoret per prodhimin e narkotike (Neni 285 i K.Penal).

Ne kete menyre është vepruar nga gjyqtari Agim Hysi ne dhenien e vendimeve penale Nr. 171 dt. 26/07/01, Nr. 120 dt. 30/05/01, Nr. 138 dt. 26/06/01, Nr. 151 dt. 06/07/01, Nr. 173 dt. 13/09/01, Nr. 174 dt. 14/09/01, Nr. 176 dt. 17/09/01, Nr. 201 dt. 22/10/01, Nr. 208 dt. 29/10/01.

K.L.D-ja konstaton se nga gjyqtari Agim Hysi është mbajtur ky qendrim ne kundërshtim me ligjin dhe praktiken gjyqesore (Vendimi Nr. 326 date 23.04.2001 i Gjykates se Larte), e cila ka saktësuar se personat qe kapen me lende narkotike "Canabis Sativa" duhet te denohen per vepren penale te

parashikuar nga Neni 283/1 i K.Penal. Per me teper, është vazhduar te mbahet ky qendrim edhe pasi Gjykata e Apelit Vlore ka ndryshuar vendimet e mepareshme te dhena nga ky gjyqtar dhe i ka denuar te pandehurit sipas Nenit 283/1 i K.Penal.

Vendimet e mesiperme, me perjashtim te Vendimit Nr. 208 dt. 29/10/01, jane ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlore.

Shkeljet e mesiperme per vete natyren e tyre dhe pasojat qe kane sjelle perbejne thyerje te rende te disiplines ne pune ne formen e veprimeve te pahijshme qe cenojne etiken gjyqesore, figuren e gjyqtarit dhe te veprimeve te kryera ne kundertshtim me permbushjen e rregullt te detyres parashikuar nga Nenet 40, 41 pika 6,7, e Ligjit Nr. 8436 dt. 28/12/98 "Per Organizimin e Pushtetit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise".


Per sa me siper Keshilli i Larte i Drejtesise mbeshtetur ne Nenet 40, 41 pikat 6,7, 42 pika 6 e Ligjit "Per Organizimin e Pushtetit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise" dhe Ligjit Nr. 8811 dt. 17/05/01 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Keshillit te Larte te Drejtesise"

V E N D O S I

Shkarkimin nga detyra te gjyqtarit te Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Vlore, Agim Hysi.

Kunder Vendimit mund te behet ankim ne Gjykatën e Larte brenda 10 diteve nga data e marrjes dijeni.

ZV/KRYETARI I K.L.D-se



Thimjo KONDI